



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 93

Prishtinë, më 6.11.2012, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S 2-Anex

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, , Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina, Boban Todorović.

Munguan : Daut Haradinaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite, fillimisht :

DËGJIMI PUBLIK
për Projektligjin për Ujërat e Kosovës

Pas dëgjimit publik, mbledhja e shtyre për sot sipas rendit të ditës :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 29.10.2012,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Mbrojtjen e bimëve,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime, ndërkaq dëgjimi publik është bashkuar me mbledhjen e paraparë të komisionit për datën 5.11.2012 për shkak të mbledhjes plenare.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 29.10.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 29.10.2012.

DËGJIMI PUBLIK

Kryetari i Komisionit Nait Hasani përshëndeti dhe falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në dëgjimin e organizuar për Projektligjin e Ujërave, ku mysafirët janë ftuar për të dhënë sugjerimet si munden të mbrohen ujërat e Kosovës në nivelin më të lartë institucional.

Sazan Ibrahim falënderoi në emër të Asociacionit të Komunave për bashkëpunim dhe shfaqti vërejtjet duke premtuar se do ti dërgoi edhe ato të specifikuara me shkrim. Ai theksoi se gjatë hartimit të këtij projekti kanë bashkëpunuar në GP të Qeverisë, mirëpo shtoi se duhet të bëhen edhe ca përmirësime tjera. Neni 13 jap kompetenca Komunave sa i përket lejeve ujore, mirëpo sipas tij, këto kompetenca më tutje në projektligj shndërrohen në delegim, çka e komplikon këtë kompetencë me rëndësi, dmth ky Ligj këtë duhet të qartësoi në mënyrë të prerë. Më tutje Këshilli ndërministror nuk ka përfaqësim lokal, çka gjithashtu është fjala për mangësi. Neni 22 pellgjet i ndanë në dy rajone ku gjithashtu nuk ka qartësi sa ka rol komuna për politikën, ngase gjithë pasuria menaxhohet prej MMPH. Nenet 56 dhe 58 ndeshet me Nenin 13. Tek Neni 50 komunat duhet të marrin pjesë me kompetenca rreth eksploatimit të zhavorrit, jo të kemi centralizim të kompetencave në Prishtinë. Tek Nenet 87 dhe 92 duhet të shkruhet qartë që ndotësi do të gjobitet rreth lartësisë së pagesës.

Avdullah Nishori (ish anëtar i Këshillit për Ujëra) tha se ky Projekt i hartuar është avancim në krahasim me Ligjin në fuqi, megjithatë :

- duhet të harmonizohen nocionet (administrim me menaxhim dhe shumë nocione tjera), referimi në shtojcë të jetë i saktë (p.sh. referohet shtojca 5, ndërkaq ajo në fakt nuk ekziston), përkufizimet e huazuara të mirën si tërësi e jo ashtu të përgjysmuara p.sh. te pellgu i lumit, statusi ekologjik patjetër të hyjë në përkufizime ngase këtë e kërkojnë DE (direktivat evropiane), rajoni i pellgut lumor të harmonizohet në tri versionet si dhe me DE, Nenet 15, 16 dhe 17 duhet të qartësojnë çfarë Këshilli po themelohet : ndërministror, ujqor apo si, duhet të qartësohet, ngase sipas tij Këshilli ndërministror nuk mund të jetë i pavarur, funksionimi dhe themelimi i Instituteve paraqet barë për buxhetin e shtetit, ndaj ato duhet të krijohen por me një rrugë ndryshe, Neni 39 duhet të qartësoi për çfarë objekte dhe pajisje është fjala, Neni 37 nuk definon si duhet kujdesin e autoritetit të pellgut.

Nga Instituti për monitorimin e ujit të pijshëm **dr. Burbuqe Nushi** kërkoi nga komisioni një Paragraf apo Nen me të cilin do të sigurohet monitorimi i ujit të pijes që do të jetë në kompetencën e IKSHK. Për shkak të dallimit të termit kontrolli nga termi monitorimi që potencoi **Afërdita Berisha**, sqarimin e ofroi dr. **Selvet Krasniqi** e cila potencoi se kontrolli është pjesë e monitorimit. Përfaqësuesi i kompanisë ujore nga Prizreni kërkoi që në Nenin 16 të shtohet një përfaqësues i pavarur, mirëpo me të njëjtin dialogoi kryesuesi **Nait Hasani** i cili pyeti çka nëse i kemi dy shoqata. **Ilir Abdullahu** nga kompania ujore në Prishtinë diskutoi për çështjen e vrojtimit të digave dhe monitorimit të tyre dhe sugjeroi që ky person juridik monitorues duhet të mbikëqyret nga Qeveria (Neni 44). Sipas tij diskutabile është edhe Neni 61 ku thuhet “përveç me leje ujore” ngase nuk do të ishte e nevojshme leje për ujërat e ndotura. Duhet të ndahen ujërat në ato rurale, urbane etj. Neni i kadastrit ujqor nuk sqaron mirë fjalën “flota”, ndërsa tek neni 51 bëhet fjalë për një kohë shumë të shkurtër e cila duhet të zgjatet, ndërkaq kompetencat për leje ujore komunale janë të tepërta, ndaj ato duhet të centralizohen.

Raif Preteni nga ZRRUK potencoi nenin 73 ku duhet të ketë një modul për lejet e shkarkimeve të ujërave të ndotura për arsye se vetëm Skenderaji bënë trajtimin e këtyre ujërave. **Hazir Çadraku** në emër të MMPH bëri rezymë për vërejtjet e parashtruara, nga të cilat disa i arsyetoi por disa edhe i konsideroi të panevojshme, ai u ndal edhe në kërkesën e ZRRUK dhe shtoi se MMPH me këto leje duhet të bëjë njëloj balancimi me zgjidhje interne dhe shpresoi se edhe

komunat tjera do të krijojnë impiantet. Kryesuesi ilustroi këtë me pyetjen : çka nëse p.sh. prishet impianti i Feroniklit, përgjigja ishte se Feronikli nuk guxon të lëshoi ujërat e ndotura përveç me leje ujore. **Ramiz Kokollari** ekspert, potencoi disa vërejtje të përgjithshme me konsekuenca buxhetore dhe disa specifike siç janë : në përkufizime nuk duhet të qëndroi “gjendja kimike” por “gjendja e mirë”, tek Neni 6 duhet të ceket një parim më fleksibil, te Neni 12 eksproprijimi duhet ti lejohet edhe Komunës, te Neni 14 Komunave t’ju mirët e drejta për planifikime strategjike të karakterit lokal dhe disa vërejtje tjera të cilat do ti parashtroi deri të premtën. **Nadire Vitija** (SHUKOS) kërkoi lehtësi tatimore për taksën e pagesave konform dispozitave evropiane ngase siç dihet ushtrimi i veprimtarive ekonomike janë të rrezikshme për resurset ujore (Neni 64).

Nijazi Idrizi kërkoi sqarimin rreth dimensionimit të politikave dhe pyeti a mundëson ky Ligj shfrytëzimin shumëqëllimor të ujërave, a parasheh standardizimet e reja, a ka konflikt interesi në mes niveleve menaxhuese dhe së fundi a parashihen taksat me të cilat do të pasuroheshin (shtohen) pyjet tona si pasuri që i kemi.

Nait Hasani në fund konstatoi se MMPH disa gjëra deri tani ka përmirësuar sa i përket këtij Projekti sidomos për drejtën e autoritetit në pellgjet lumore, Këshilli për ujëra të harmonizohet çfarë këshilli është etj, ndaj përpjekjet do të vazhdojnë në Grupin Punues ku mund të dërgohen vërejtjet deri të premtën më 9 nëntor. **Liburn Aliu** sqaroi për mënyrën e paraqitjes së vërejtjeve veç e veç për Nenet konkrete, ngase ato të përgjithshme vështirë inkorporohen në Ligj.

Kryetari i Komisionit falënderoi për pjesëmarrje.

Pas mbledhjes janë dërguar disa vërejtje me shkrim, të cilat do të bashkëngjiten procesverbalit si material për grupin punues.

Shqyrtimi i Projektligjit për Mbrojtjen e Bimëve

Kryetari i Komisionit sugjeroi të shqyrtohen dhe të votohen vërejtjet e grupit punues për Projektligjin për Mbrojtjen e bimëve, ndaj Komisioni nxori dhe vendosi si vijon :

Amendamenti 1

Në Preambulë fjala “**PROJEKTLIGJIN**” zëvendësohet me “**LIGJIN**”

Amendamenti 2

Neni 3, në paragrafin 1.3 fjalia “**Departamenti i Prodhimit dhe Mbrojtjes së Bimëve**” zëvendësohet me “**Departamenti për politika bujqësore, tregjet dhe i tregtisë**”

Në paragrafin. 1.12 , fjala „**ekzaminim**„ në rreshtin e 1 dhe në tërë tekstin e Projektligjit, zëvendësohet me „**kontrollë**”.

Në paragrafin. 1.12 rreshti i 5 pas fjalës “**dëmshtëm**” fshihet “**dhe/apo**”.

Në paragrafin 1.21, rreshti i 2 pas fjalës “**lloj**” fshihet „**soji, shtam**”.

Amendamenti 3

Neni 6

Paragrafi 1.1 , rreshti i 7 pas fjalës “**fidanishte**” shtohet fjala „**kopshte**” dhe vazhdon teksti.

Paragrafi 1.2. fjala “**shfaqje**” ne rreshtin e 4 zëvendësohet me falën “**paraqitje**”.

Amendamenti 4

Neni 7, riformulohet titulli :

“**Listat e organizmave të dëmshtëm që rregullohen me këtë Ligj**”.

Amendamenti 5

Neni 10, paragrafi 1 në rreshtin e 7 dhe paragrafi 2 në rreshtin e 3; pas, fjalës “**Kosovës**” shtohen fjalët “**Universitetet përkatëse**”.

Neni 28 paragrafi 5, në rreshtin 12 pas, fjalës “**Kosovës**” shtohen fjalët “**Universitetet përkatëse**”

Neni 38 paragrafi 5. në rreshtin e 12, pas fjalës “**Kosovës**” shtohet “**Universitetet përkatëse**”.

Neni 40 paragrafi 1, në rreshtin e 8; pas, fjalës “**Kosovës**” shtohen fjalët : “**Universitetet përkatëse**”.

Neni 52 paragrafi 1.2, në rreshtin e 3 pas fjalës “**Kosovës**” shtohet “**Universitetet përkatëse**”.

Amendamenti 6

Titulli i **nenit 16**, riformulohet si vijon:

“Hyrja dhe bartja e materialit për hulumtim shkencor apo për qëllim të seleksionimit klonal”.

Paragrafi 1.3 riformulohet :

“plotësojnë kushtet e parapara profesionale, shkencore dhe teknike, të përcaktuara nga organi kompetent”

Amendamenti 7

Neni 18, paragrafi 2 në rreshtin e 3 fjala “**fryte**” zëvendësohet me “**fruta**”.

Amendamenti 8

Riformulohet titulli i kreut V, si vijon :

**“REGJISTRI I PRODHUESVE PAKETUESVE, PËRPUNUESVE, IMPORTUESVE,
SHËRNDARËSVE DHE DEPONUESVE TË BIMËVE”**

Amendamenti 9

Neni 24, paragrafi 5 riformulohet :

5. Çfarëdo dërgesë tjetër e materialit bimorë, materialit prej druri i cili përdoret në paketimin apo transportimin e materialit bimorë, ambalazhit apo mjeteve me të cilat transportohet materiali bimorë duhet ti nënshtrohet kontrolleve inspektuese në pikën e hyrjes nëse inspektori fitosanitar dyshon se ka rrezik për përhapjen e organizmave të dëmshëm në bimë.

Amendamenti 10

Neni 45 paragrafi 1.8, riformulohet si ne vijim: “**Universitetet përkatëse dhe Institutet e akredituara hulumtuese;**”

Amendament 11

Neni 61

Fjala “**nxirren**” zëvendësohet me “**i nxjerr Ministria**”

Amendament 12

Aneksi I, Pjesa A (a).fjala „**këpusha**„ zëvendësohet me „**merimanga**”.

Mbledhja përfundoi në orën 13,45.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani

